



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Të mërkurën e kaluar, më 28 shkurt, në gjykimin *Thaçi dhe të tjerët* Trupi Gjykses informoi palët lidhur me datat shtesë të planifikuara për seanca në atë çështje gjyqësore deri në fund të vitit 2024.

Kalendari i përditësuar i seancave deri në fund të vitit 2024 në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët* gjendet aktualisht në kalendarin e Gjykatës në faqen e internetit të DHSK-së.

Pas përfundimit të dëshmisë së dëshmitarit të 48-të të thirrur nga Prokuroria më 28 shkurt, mbajtja e seancave gjyqësore u shty për javën. Seanca tjetër në këtë çështje gjyqësore është caktuar për të hënë, 18 mars, në orën 09:00.

Në gjykimin *Pjetër Shala*, sikurse është njoftuar më parë, seancat gjyqësore për deklaratat përmbyllëse janë caktuar për 15-19 prill 2024.

Ndaj z. Shala janë ngritur katër akuza për krime lufte (ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje e paligjshme). Krimet e pretenduara u kryen afërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999 kundër personave që u mbajtën të ndaluar në fabrikën e metalit në Kukës, Shqipëri, që pretendohet se përdorej nga UÇK-ja. Janë tetë viktimat që marrin pjesë në proces.

Gjatë gjykimit, 22 dëshmitarë dëshmuan në sallën e gjyqit: 10 të thirrur nga Prokuroria, 2 të thirrur nga Mbrojtësi i Viktimave dhe 10 të thirrur nga Mbrojtja.

Më 9 shkurt, Trupi Gjykses mbylli procedurën e paraqitjes së provave në gjykim dhe urdhëroi palët të dorëzonin dosjet gjyqësore përfundimtare të tyre, së bashku me deklaratën në lidhje me pasojat e veprave penale të pretenduara mbi viktimat pjesëmarrëse në proces, deri më 25 mars.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

